
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	---	--

Datë/a:	30.03.2018.
Për/ Za/ To:	“ROJET E NDERIT” sh.p.k.
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.03.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “ROJET E NDERIT” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 17 148 211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri vlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “ROJET E NDERIT” sh.p.k. të dt. 28.03.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616 17 148 211 , kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK –së, të datës 22.03.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës”, me Nr. 616 17 5437 211 Nr. Brendshëm 616 17 148 211 dhe mbështet njoftimin për dhënie të kontratës ;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 25.12.2017 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: “*Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës*”, me Nr. 616 17 5437 211 Nr. Brendshëm 616 17 148 211.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 05.02.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 22.03.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë ri-njoftimin për dhënie të kontratës pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Ri-Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje.

Me datë 27.03.2018, Operatori Ekonomik “ROJET E NDERIT” sh.p.k, iu ka lejuar çasja në dokumentacion të të gjitha ofertave lidhur me këtë tender.

Operatori Ekonomik “ROJET E NDERIT” sh.p.k të dt. 28.03.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “*Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës*”, me Nr. 616 17 5437 211 Nr. Brendshëm 616 17 148 211, kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK – së, të datës 02.03.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A, te paragrafit 1,2,3,4,5,6,7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, dhe në kërkesat për pjesëmarrje në dosjen e tenderit në të cilin theksohet:

a) *Pretendimi 1: OE fitues ka dorëzuar vërtetimet e Gjykatës dhe ATK-së kush që duhet të përmbushet para njoftimit për dhënie të kontratës por njëri nga ta pa afat.*

b) *Pretendimi 2: OE fitues ka sjellur kopjet e licencave, por ne shprehim shqetësimin tonë se OE fitues në këtë list ka ofruar kopje të licencave të punëtorëve që nuk janë pjesë e këtij OE.*

c) *Pretendimi 3: Çmimi i ofruar nga ana e OE fitues nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e AK-së pasi që me një çmim të tillë nuk janë llogaritur të gjitha taksat e aplikueshme në Republikën e Kosovës.*

(Për arsye të afatave ligjore ne gjatë ditës së nesërme (29.03.2018) do t’ua dërgojm edhe analizën financiare lidhur me çmimin e papërgjegjshëm të OE fitues.

I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

Autoriteti Kontraktues ka bërë ri-vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin dhe ri-vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari nenin 6 (Parimi i Efikasitetit dhe Ekonomizimit) dhe nenin 7 (Parimi i Barazisë / jo diskriminimit) të Ligjit për Prokurimin Publik të konsoliduar me Nr. 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues lidhur me pretendimet e OE që ka bërë kërkesë për rishqyrtim të datës 28.03.2018 duke respektuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik si dhe Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik ka marrë vendim:

a) Pretendimi 1 - Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit dhe ri-vlerësimit të ofertave në veçanti të Operatorit Ekonomik fitues ka kërkuar që të sjell vërtetimin tatimor dhe vërtetimin nga Gjykata konform rregullave dhe dispozitave ligjore siç i parasheh Ligji i Prokurimit Publik, cili i ka sjellur këto dokumentacione të cilat janë në dosje duke respektuar nenin: 65 të LPP-së si dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik si dhe sipas kërkesës së parashtruar në FTD pika 6.4.

b) Pretendimi 2 - OE ankimor ka bërë pretendime se OE fitues ka sjellur kopjet e licencave, por në shprehim shqetësimin tonë se OE fitues në këtë list ka ofruar kopje të licencave të punëtorëve që nuk janë pjesë e këtij OE. Autoriteti Kontraktues lidhur me pretendimet e OE ka vendosur që të mos e marrë për bazë këtë pretendim sepse OE ka përmbushur kërkesën e parashtruar në FTD pika 9.1 dhe 9.2. Autoriteti Kontraktues vendos që të vazhdoj të respektoj Kërkesat e parashtruara në DT mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të pikës 9.1 dhe 9.2 ku dëshmia e përcaktuar ka qene qe OE i propozuar për dhënie të kontratës të sjelle kopjet e licencave të punëtorëve, gjë të cilën OE i propozuar për kontratë i ka dorëzuar në përputhje me kërkesën e përcaktuar

c) Pretendimi 3 - Çmimi i ofruar nga OE fitues plotëson nevojat financiare pasi që autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin e analizave financiare të ofertës së OE fitues. Autoriteti Kontraktues nuk lëshohet në pretendime fiktive të pabazuara dhe aspak të argumentuara.

OE ankimor nuk ka sjellur dëshmitë dhe provat e pretenduara se do të sjellë me datë 29.03.2018 në lidhje me analizën financiare, duke u bazuar vetëm në pretendim fiktiv e aspak argumentues dhe provues.

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe duke zbatuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik vendos si në dispozitivin e cekur më lartë

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

